

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

LIGJI Nr. 2003/16

Duke u mbështetur në Kapitullin 5, pika 5.1. (k) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 të datës 15 maj 2001) dhe nenit 2 pika 2.2. shtojca IX pika (iX) të Rregullorës së UNMIK-ut nr.2001/19 Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme për Vetëqeverisje në Kosovë, në Seksionin I pika 1.2. dhe Seksionin 2 pika (g) të Rregullorës së UNMIK-ut nr.2001/14 të datës 2 korrik 2001 me të cilën është formuar Enti Statistikor i Kosovës, si dhe në Propozimin e Qeverisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës, në mbledhjen e tij të rregullt të datës 11.07.2003 miratoi :

LIGJIN
PËR REGJISTRIMIN E POPULLSISË, TË EKONOMIVE
FAMILJARE DHE TË BANESAVE NË KOSOVË

Kapitulli I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Ligj përcaktohet:

- a) mënyra e organizimit dhe e zhvillimit të procesit të Regjistrimit të Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave në Kosovë (në tekstin e mëtejshëm: regjistrimi);
- b) formimi, përbërja, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të cilat e organizojnë, e ndihmojnë dhe e bëjnë regjistrimin,
- c) fillimi, kohëzgjatja dhe përfundimi i procesit të regjistrimit,
- ç) dokumentacioni i nevojshëm për kryerjen e regjistrimit,
- d) procedura për sistemimin, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave të dala nga rezultatet e regjistrimit,
- dh) mënyra dhe forma e publikimit të të dhënave si dhe ruajtja e fshehtësisë profesionale” dhe
- e) masat administrative kundër shkelësve të dispozitave të këtij Ligji.

Neni 2

Qëllimi i regjistrimit

1. Me Regjistrim përfshihet grumbullimi, sistemimi dhe administrimi sipas standardeve bashkëkohore i të dhënave të sakta si dhe i informacioneve të tjera mbi popullsinë, ekonominë familjare dhe banesat në Kosovë, të nevojshme për institucionet e Kosovës (Presidencën, Qeverinë, Kuvendin e Kosovës dhe komunat), për organizatat ekonomike, institucionet shkencore dhe ato kulturore, për organizatat qeveritare dhe joqeveritare, për punëtorët e shkencës dhe të kulturës si dhe për të interesuarit të tjerë, me qëllim të planifikimit dhe të zbatimit të politikave të përgjithshme zhvillimore, për vendimmarrje, për hulumtime shkencore dhe analiza të tjera të nevojshme për fusha të ndryshme të shoqërisë kosovare.
2. Regjistrimi duhet të sigurojë të dhëna mbi:
 - a. Numrin dhe shpërndarjen gjeografike të popullsisë;
 - b. Strukturën demografike dhe karakteristikat kryesore socio-ekonomike të popullsisë;
 - c. Numrin, shpërndarjen gjeografike dhe strukturën e venbanimeve dhe të ndërtesave të shfrytëzuara për qëllime banimi;
 - d. Kushtet e banimit të popullsisë.

Neni 3

Përkufizimi i shprehjeve

Në kuptim të këtij ligji shprehjet e cekura më poshtë duhet të kuptohen në këtë mënyrë:

- a) **“Popullsi vendëse”** nënkupton popullsinë e përbërë nga individë të cilët, në ditën e regjistrimit, ata apo të afërmit e tyre, ia ofrojnë personelit që kryen regjistrimin, dëshminë se janë banorë të përhershëm të Kosovës si dhe ata që, përkohësisht gjenden jashtë Kosovës.

Popullsi vendëse në kuptim të pikës a) të këtij neni, nuk konsiderohet personeli i UNMIK-it, i KFOR-it, ai i zyrave të vendeve të huaja të ndërlidhjeve që gjenden në Kosovë, i organizatave të huaja qeveritare dhe joqeveritare, refugjatët, si dhe, shtetasit e huaj të cilët janë përkohësisht në Kosovë.

- b) **“Banesa”** duhet të nënkuptoj një ose më shumë hapësira, të destinuara për banim, që kanë një dalje të pavarur në rrugë dhe që në momentin e regjistrimit është i banuar apo është destinuar për banimin e një individi apo grupi individësh.

Perkufizimet tjera që do të përdoren gjatë procesit të regjistrimit do të definohen në udhëzimet metodologjike të regjistrimit.

Neni 4
Obligimi për t'u përgjegjur

Obligohen të gjithë qytetarët e Kosovës që, ditën e regjistrimit, personelit që kryen regjistrimin, t'ja ofrojnë të gjitha të dhënat e sakta për vete dhe për të afërmit e tyre.

Neni 5
Autoriteti i regjistrimit

Regjistrimin e bën dhe e organizon Enti Statistikor i Kosovës përmes organeve përkatëse të përcaktuara në kapitullin II, të këtij ligji nën mbikqyerjen e drejtëpërdrejt të Komisionit Qendror të Regjistrimit.

Neni 6
Afati brenda të cilit do të bëhet regjistrimi

Koha (data, muaji dhe viti) për kryerjen e regjistrimit përcaktohet me Vendim të posaqëm që do ta nxjerrë Kuvendi i Kosovës.

Neni 7
Objekt i regjistrimit

1. Regjistrimi i përfshinë të gjitha vendbanimet urbane dhe rurale, në mbarë territorin e Kosovës.
2. Regjistrimi përfshinë popullsinë vendëse dhe të gjitha ndërtesat brenda territorit të Kosovës që shfrytëzohen për banim, pavarësisht a janë ato prona të tundshme apo të patundshme, me gjendjen e para 23 marsit të vitit 1989.

Neni 8
Të dhënat e grumbulluara nga regjistrimi

Të dhënat e grumbulluara nga regjistrimi kategorizohen në:

- a) të dhënat për identitetin e individit (emrin, emrin e babës, të nënës dhe mbiemrin, datën, muajin, vitin dhe vendin e lindjes, përkatësinë kombëtare e gjinore si dhe adresën- vendbanimin e përhershëm) dhe,
- b) të dhënat mbi strukturën dhe karakteristikat e objekteve të banimit, të familjeve dhe të individëve, të kërkuara vetëm për qëllime statistikore e në harmoni me standardet ndërkombëtare.

Neni 9

Mbrojtja e të dhënave dhe fshehtësia profesionale

Organet e përcaktuara në Kapitullin II të këtij Ligji, gjatë dhe pas procesit të regjistrimit, garantojnë:

- a) ruajten e fshehtësisë së plotë profesionale dhe të dhënave personale të të regjistruarve në përputhje me dispozitat e Rregullorës 2001/4 mbi themelimin e Entit Statistikor të Kosovës,
- b) parandalon qasjen e paautorizuar në bazën (Qendrën) e të dhënave personale,
- c) trajtimin si “të dhëna anonime” e të gjitha të dhënave personale të të regjistruarve, gjatë dhe pas regjistrimit, kontrollit teknik dhe të vërtetimit të saktësisë së tyre.
- d) Të dhënat e grupëzuara dhe të dhënat anonime individuale mund t’i komunikohen një pale të tretë të autorizuar vetëm për qëllime që janë në harmoni me qëllimet statistikore të regjistrimit. Pranuesi i të dhënave i nënshtrohet obligimit për mbrojtjen e fshehtësisë profesionale të të dhënave; pranuesi duhet t’i ndërmarrë masat përkatëse të sigurisë dhe të garantojë se çdo publikim i rezultateve statistikore do të jetë në pajtim me dispozitat ligjore.

Neni 10

Rezultatet e regjistrimit

ESK, në përputhshmëri me dispozitat e Rregullorës nr. 2001/4, dhe të këtij Ligji, bën komunikimin dhe publikimin e rezultateve preliminare dhe të atyre përfundimtare të regjistrimit.

Neni 11

Regjistrat dhe Pyetsorët (formularët) për Regjistrim

Për kryerjen e regjistrimit dhe për grumbullimin sa më të plotë të të dhënave të nevojshme, ESK, bashkë me Zyren e Regjistrimit, përgaditë Regjistrat, Pyetsorët dhe dokumentacionin tjetër përkatës, për regjistrimin e të dhënave identifikuese të individëve, të banesave, të rrugëve (adresave), të vendbanimeve, të ekonomive familjare dhe të ndërmarrësve individualë të cilët, në ditën e regjistrimit deklarohen si të vetëpunësuar (në bujqësi, në industri, në zejtarë apo në shërbime të tjera publike) si dhe kapaciteti i biznesit të tyre.

Kapitulli II

ORGANET PËRGJEGJËSE PËR REGJISTRIM, PËRBËRJA E TYRE, KOMPETENCAT DHE RAPORTET E TYRE

Neni 12

Komisioni Qendror i Regjistrimit

1. Komisioni Qendror i regjistrimit përbëhet nga përfaqësuesit e:

1. Qeverisë së Kosovës	Kryesues
2. Ministrisë së Shërbimeve Publike	Zv. Kryes.
3. Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave	Anëtar
4. Ministrisë së Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe i Çështjeve Jorezidente	Anëtar
5. Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Anëtar
6. Agjencionit të Kadastrit të Kosovës	Anëtar
7. Entit të Statistikës së Kosovës	Anëtar
8. Zytari Kryesor Ndërkombëtar nga Ministria e Shërbimeve Publike	Anëtar
9. Zytari Ndërkombëtar nga Enti i Statistikës i Kosovës	Anëtar

2. Me propozim të Qeverisë, Komisionin Qendror të Regjistrimit e zgjedhë Kuvendi i Kosovës.

Neni 13

Kompetencat e Komisionit Qendror të Regjistrimit

Komisioni Qendror i Regjistrimit :

- Përpilon dhe miraton akte nënligjore që e funksionalizojnë këtë ligj.
- Mbikëqyrë përgatitjen dhe mbarëvajtjen e regjistrimit si dhe e udhëzon ESK-në për informacionet që i kërkojnë autoritetet publike, qarqet shkencore dhe shoqëria civile.
- Garanton koordinimin e punëve midis autoriteteve publike dhe qarqeve shkencore dhe shoqërisë civile.
- I propozon Qeverisë anëtarët e Komisioneve Komunale të Regjistrimit si dhe ua definon detyrat.

Neni 14

Enti i Statistikës

Enti i Statistikës i Kosovës (ESK) :

- Përpilon programin e punës, definon metodologjinë, zgjedhë mjetet përkatëse teknike dhe programet e softverit, harton pyetësorët, nxjerrë udhëzime dhe vendime të domosdoshme dhe udhëheq në mënyrë të pavarur përgatitjet për realizimin e regjistrimit mbi baza shkencore.

- b. Udhëheq personelin e angazhuar në procesin e regjistrimit dhe burimet financiare të siguruara për regjistrim dhe i raporton Komisionit Qendror të Regjistrimit dhe donatorëve ndërkombëtar, përkitazi me shfrytëzimin e këtyre burimeve.
- c. Informon autoritetet dhe organet relevante qeveritare mbi hapat që duhet të ndërmerren lidhur me regjistrimin, zhvillon fushatën e informimit të publikut dhe i raporton Komisionit Qendror mbi zhvillimin e procesit të regjistrimit.
- d. Përkufizon kushtet e referencës dhe udhëzimet për trajnime të cilat duhet t'i zbatojnë komisionet dhe zyrat komunale të regjistrimit me rastin e zgjedhjes dhe trajnimit të personelit të regjistrimit. Realizon punën në terren, në bashkëpunim me organet komunale të regjistrimit, duke i regjistruar vendbanimet dhe ndërtesat si dhe i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për kompletimin me kohë dhe të saktë të regjistrimit.
- e. Prezenton dhe publikon rezultatet preliminare dhe finale të regjistrimit.
- f. Zyra statistikore ka të drejtë të nxjerr instruksione statistikore sipas nevojës për zbatimin e ligjit.

Neni 15

Organet komunale të regjistrimit

Në bazë të propozimit të Komisionit Qendror të Regjistrimit, Qeveria themelon Komisionin dhe Zyrën e Regjistrimit në çdo komunë. Kjo Zyrë i ka këto detyra:

- a. Në bazë të udhëzimeve dhe vendimeve të ESK, i ndërmerr të gjitha masat e domosdoshme për zhvillimin normal të operacioneve të regjistrimit dhe kryen përgatitjet dhe realizimin e Regjistrimit në mbarë territorin e komunës, si dhe i siguron informacionet dhe ndihmon personelin e regjistrimit nëpër qytete dhe fshatra.
- b. I zgjedhë dhe i trajnon anketuesit dhe e kontrollon zbatimin e detyrave të tyre.
- c. I raporton çdo javë ESK-së lidhur me zhvillimin e procesit të regjistrimit brenda territorit të komunës, ndësa gjatë javës së regjistrimit raporton çdo ditë.
- d. Ndërmerr hapa përkatës për sigurimin e pranimit dhe depozitimit adekuat të materialeve të regjistrimit në komunë dhe me pas dorëzimin e tyre në ESK.

Kapitulli III

Buxheti

Neni 16

1. Obligohet Qeveria e Kosovës që, brenda dy muajve nga dita e shpalljes së këtij Ligji, t'ia paraqesë për miratim Kuvendit të Kosovës propozimin e Listës për anëtarë të Komisionit Qendror të Regjistrimit si dhe Projektlllogarinë e shpenzimeve të përgjithshme për përgaditjen dhe zhvillimin normal të procesit të regjistrimit.
2. Kuvendi i Kosovës, pas pranimit të dokumenteve nga paragrafi 1 i këtij neni, në seancën e tij të parë të radhës, do t'i shtrojë ato për debatim dhe miratim.

Kapitulli IV

PROCEDURAT E REGJISTRIMIT

Neni 17

Publiciteti

- a) ESK, përmes mediave dhe fushatës së gjërë të informimit, do t'i bëjë publike qëllimet, procedurat dhe obligimet përkatëse ligjore të regjistrimit.
- b) Informimi i përgjithshëm i publikut lidhur me realizimin e regjistrimit në Kosovë, duhet të fillojë menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji.
- c) Fushata informative intensive ditore duhet të fillojë së paku dy muaj para fillimit të regjistrimit.

Neni 18

Agjencioni i Kadastrës së Kosovës

Agjencioni i Kadastrës së Kosovës (AKK) duhet t'i vë me kohë në dispozicion ESK-së hartat dhe informacionet tjera gjeografike dhe hartografike që janë të nevojshme për realizimin e regjistrimit.

Neni 19

Administrata lokale dhe komunat

1. Departamenti përgjegjës për administratën lokale dhe komunat duhet t'i përkufizojë, në mënyrë të qartë, emërtimet e rrugëve në të gjitha qytetet dhe fshatrat e Kosovës, para fillimit të regjistrimit. Komunat, poashtu, do të themelojnë dhe mirëmbajnë sistemin e adresave në përputhshmëri me nenin 11 të këtij Ligji.
2. Departamenti përgjegjës për administratën lokale dhe komunat duhet ta mirëmbajë një sistem stabil dhe të qartë të emërtimeve dhe adresave të të gjitha vendbanimeve në Kosovë.

Neni 20

Qendra Kryesore e Përpunimit të të dhënave

Qendra Kryesore e Përpunimit duhet t'i vë në dispozicion ESK-së të gjitha informacionet, materialet apo paisjet e nevojshme për realizimin e Regjistrimit.

Neni 21

Personeli i Regjistrimit

1. Personelin e Regjistrimit e përbëjnë:
 - a. Anketuesit, të pajisur me distinktivin zyrtar, shkojnë në çdo banesë për t'i intervistuar banuesit duke i plotësuar saktësisht pyetësorët e regjistrimit;
 - b. Numri i përpunuesëve që bëjnë shifrimin dhe kontrollin e materialit;

- c. Kontrollorët, e ndihmojnë dhe e kontrollojnë punën e një numri të anketuesëve;
- d. Mbikëqyrësit, e ndihmojnë dhe e kontrollojnë punën e një numri të kontrollorëve;
- e. Përpunuesit e të dhënave me dorë dhe operaterët për përfshirjen e të dhënave nga pyetsori në sistemin kompjuterik;
- f. Personeli Menaxhues, bën organizimin dhe pëgatitjen e informacioneve, logjistikën dhe administrimin e regjistrimit;
- g. Statisticientët, demografët dhe personeli tjetër, bëjnë përpunimin e të dhënave, analizimin e të dhënave të grupëzuara dhe prodhimin e rezultateve të regjistrimit;
- h. Këshilltarët teknik ndërkombëtar.

2.ESK i cakton kriteret për zgjedhjen, angazhimin dhe trajnimin e personelit të regjistrimit, ndërsa:

- a.Caktimin e anketuesëve e bëjnë zyrat komunale të regjistrimit;
- b.Caktimin e kontrollorëve e bën ESK, në bazë të propozimit të zyrave komunale të regjistrimit;
- c.Caktimin e mbikëqyrësve e bën ESK;
- d.Caktimin i përpunuesëve me dorë, operatorëve, personelit menaxhues dhe ekspertëve shkencor e bën ESK.

Neni 22

Ndalimi i grumbullimit të të dhënave të ngjashme

1. Mbrenda periudhës kohore prej 6 muajve para realizimit të Regjistrimit si dhe gjatë kohës së grumbullimit të të dhënave nga Regjistrimi, u ndalohet të gjithë individëve dhe organizatave vendore dhe ndërkombëtare që të grumbullojnë të dhëna të ngjashme brenda territorit të Kosovës.
2. Në pajtim me ligjin në fuqi, të gjitha subjektet të cilat, gjatë periudhës së cekur më lartë, synojnë grumbullimin e të dhënave mbi individët dhe banesat apo aktivitetet e tyre private dhe komerciale, duhet të kërkojnë autorizim special nga Komisioni Qendror i Regjistrimit.

Kapitulli V

MASAT NDESHKUESE

Neni 23

Kundërvajtjet

1. Çdo shkelje e rregullave të parapara me nenet 4 dhe 9 do të konsiderohet vepër kundërvajtëse dhe do të ndëshkohet me gjobë prej 1.000 deri 2.000 E.

2. Çdo mospërfillje e rregullave të parapara me Nenin 19, do të konsiderohet vepër kundërvajtëse dhe do të ndëshkohet me gjobë prej 1.500 deri 3.000 E.

Neni 24

Ndëshkimet me gjoba për kundërvajtje administrative të parapara me Nenin 22 i shqipton kryetari i Komisioni Komunal të Regjistrimit. Ankesa kundër këtij vendimi mund t'i paraqitet Komisionit Qendror të Regjistrimit brenda 10 ditësh, që nga dita e marrjes së vendimit. Ankesa kundër vendimit të Komisionit Qendror të Regjistrimit mund t'i paraqitet Gjykatës për kundërvajtje brenda 10 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

Kapitulli VI DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 25

Obligohet Qeveria e Kosovës që, brenda dy muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Ligji, t'i nxjerrë aktet nënligjore në harmoni me dispozitat e neneve 11- 21 të këtij Ligji.

Neni 26

Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, pushojnë se vepruari të gjitha dispozitat e deritashme të cilat e kanë rregulluar këtë materje.

Neni 27

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e shpalljes.

Ligji Nr.2003 / 16
11.07.2003

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik Nexhat Daci